

SA RESILIENCE – Water for Fire

IPA South Adriatic 2021–2027

Projekt për forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe vendore për menaxhimin e zjarreve në pellgun e lumit Shkumbin, duke siguruar burime të qëndrueshme ujore dhe duke përmirësuar koordinimin institucional, planifikimin dhe reagimin në përputhje me standardet e BE-së.



UJË

Burime të qëndrueshme ujore për fikjen e zjarreve



ZJARR

Përgjigje më e shpejtë dhe efektive ndaj zjarreve



MBROJTJE

Forcimi i kapaciteteve dhe sigurisë së komuniteteve



BASHKËPUNIM

Koordinim institucional dhe partneritet i qëndrueshëm

TË DHËNA KRYESORE



7 BASHKI

Përrenjas, Librazhd, Elbasan, Peqin, Rrogozhinë, Divjakë, Kavajë



3 QARQE

Tiranë, Fier, Elbasan



PËRFSHIN

Zona pyjore, rurale dhe bujqësore dhe qendrat urbane me rrezik të lartë nga zjarret



QËLLIMI I PROJEKTIT



- ✓ Forcimi i kapaciteteve kombëtare dhe vendore për përgjigje ndaj zjarreve në pyje dhe zonave urbane.
- ✓ Sigurimi i burimeve të qëndrueshme ujore për fikjen e zjarreve në pellgun e lumit Shkumbin.
- ✓ Mbështetja e mekanizmeve të parandalimit, reagimit dhe planifikimit në përputhje me Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së dhe Planit Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike.
- ✓ Kontribut në kapitullin 27 të procesit të integritimit të Shqipërisë në BE (Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike).

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

1



Hartëzimi dhe vlerësimi i burimeve ujore të disponueshme për ndërhyrje në zjarre në zonat pyjore dhe rurale me rrezik zjarri.

2



Vlerësimi dhe përmirësimi i furnizimit me ujë për shërbimet zjarrfikëse dhe rrjetet e hidranteve në zonat urbane.

3



Hartimi i një plani veprimi me masa praktike (investime në infrastrukturë, veprime në nivel politikash) për të siguruar disponueshmëri të qëndrueshme të ujit për fikjen e zjarreve.

4



Ndërtimi i kapaciteteve lokale dhe përafrimi i rekomandimeve me legjislacionin kombëtar dhe standardet e BE-së mbi mbrojtjen civile, burimet ujore dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

AKTIVITETET KRYESORE



ZONAT RURALE/PYJE

Vlerësimi i burimeve ujore në zonat rurale të rrezikuara nga zjarret:

Identifikimi i zonave me rrezik të lartë dhe hartëzimi i burimeve ujore përreth; vlerësimi i kapaciteteve, aksesueshmërisë dhe përdorimit të tyre gjatë sezonit të thatë.

Plan rekomandimesh/sugjerimesh



ZONAT URBANE

Vlerësimi i furnizimit me ujë për shuarjen e zjarreve në zonat urbane:

Inventarizimi i hidranteve, analiza e furnizimit me ujë në stacionet zjarrfikëse dhe identifikimi i boshllëqeve si mungesa e hidranteve apo depozita të pamjaftueshme.

Plan rekomandimesh/sugjerimesh



REKOMANDIME

Hartimi i rekomandimeve dhe sugjerimeve konkrete për investime në infrastrukturë; përmirësimet në politika dhe rregullore, si dhe për masa organizative për një përgjigje më efektive ndaj zjarreve.

Plan rekomandimesh/sugjerimesh



Albanian Water Partnership



DIPER
SH.P.K.

STAKEHOLDER ENGAGEMENT AND MAPPING

RAPORT

SA RESILIENCE – Water for Fire

IPA South Adriatic 2021–2027



QËLLIMI I RAPORTIT

Ky dokument, Raporti i Angazhimit të Palëve të Interesuara, është pjesë integrale e fazës së parë të zbatimit të projektit. Qëllimi kryesor i tij është të dokumentojë procesin e identifikimit, konsultimit dhe përfshirjes së të gjitha aktorëve përkatës që luajnë një rol në menaxhimin e burimeve ujore dhe kapaciteteve për shuarjen e zjarreve në basenin lumor Shkumbin.



METODOLOGJIA

Procesi i angazhimit u zhvillua përmes një qasjeje të strukturuar dhe fleksibël që kombinon analizën e dokumenteve ekzistuese, konsultimet institucionale dhe vizitat në terren.

U identifikuan dhe u kontaktuan institucionet në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, përfshirë 6 bashki dhe 3 prefektura.

U realizuan 12 vizita në terren, u zhvilluan takime dhe intervista, dhe u shpërndanë 12 pyetësorë për të mbledhur të dhëna mbi burimet ujore dhe kapacitetet për shuarjen e zjarreve.



6

Bashki të angazhuara



3

Prefektura të përfshira



20

Institucione të kontaktuar



12

Pyetësorë të plotësuar



59

Persona të kontaktuar



12

Vizita në terren



KUDRI LIGJOR DHE POLITIKAT

Angazhimi i palëve të interesuara bazohet në kuadrin ligjor dhe politik të BE-së dhe të Shqipërisë, duke përfshirë:

- Direktiva Kuadër për Ujërat e BE-së 2000/60/EC
- Direktiva e BE-së për Përmbytjet 2007/60/EC
- Mekanizmi i Mbrojtjes Civile i BE-së 1313/2013/EU
- Ligji nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”
- Ligji nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore”
- Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (NDRRS 2023–2030)
- Plani Kombëtar i Emergjencave Civile 2023 PKEC)
- Plani Kombëtar i Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike (2023–2030)
- Konventa e Aarhus-it 1998)



GJETJET KRYESORE

Strukturat ekzistuese, por kapacitetet mbeten të kufizuara: MZSH është i organizuar si strukturë e veçantë në shumicën e rasteve, ndërsa strukturat e emergjencave civile zakonisht funksionojnë me 3–5 punonjës; aty ku raportohet qartë, stafi MZSH varion afërsisht nga 15 deri në 35 punonjës.



Problemi kryesor nuk është mungesa absolute e ujit, por aksesit operacional ndaj tij: mbulimi me hidrante është shumë i pabarabartë dhe i përqendruar kryesisht në zonat urbane. Shembuj tipikë janë: 2 hidrante funksionale në Elbasan, 6 në Divjakë, 12 në Librazhd, rreth 16 në Përrenjas, ndërsa Rrogozhina ka vetëm 1 hidrant në stacion dhe Kavaja nuk ka hidrante funksionale në rrjetin urban.



Zjarret lidhen kryesisht me faktorë njerëzorë, jo natyrorë: pakujdesi, djegie të qëllimshme, pastrime parcelash dhe në disa raste linja elektrike. Zonat ku zjarret nisin më shpesh janë pranë tokave bujqësore, rrugëve dhe zonave të banuara, ndërsa zjarret në thellësi të pyjeve janë më pak të shpeshta, por më të vështira për t'u menaxhuar.



Boshllëqet kryesore janë: mungesa e hidrantëve dhe pikave ujore në zonat rurale/pyjore, vështirësitë e aksesit, mungesa e mjeteve dhe pajisjeve, dobësia e sistemeve të paralajmërimit dhe mungesa e digitalizimit/GIS.

MATRICA E FUQISË DHE NDIKIMIT TË AKTORËVE

| Fuqia / Ndikimi | Ndikim i lartë | Ndikim i ulët |
|-----------------|--|---|
| Fuqi e lartë | <p>Vendimmarrës kryesorë dhe aktorë strategjikë</p> <ul style="list-style-type: none">• Komiteti Ndërmisor për Emergjencat Civile• Komiteti i Mbrojtjes Civile• Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile• Ministria e Mbrojtjes / Forcat e Armatosura• Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit• Prefekturat (Elbasan, Tiranë, Fier) | <p>Nuk është identifikuar asnjë aktor në këtë kategori për këtë projekt.</p> |
| Fuqi e ulët | <p>Aktorë operacionalë dhe teknikë</p> <ul style="list-style-type: none">• Bashkitë• Shërbimet Vendore të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit• Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura• Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura• Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore | <p>Aktorë mbështetës / dytësorë</p> <ul style="list-style-type: none">• Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)• Ujësjellës Kanalizime• Qendrat Shëndetësore / Njësitë e Emergjencës• Policia e Shtetit• Drejtorite arsimore• Agjencia Kombëtare e Pyjeve |

STAKEHOLDER ENGAGEMENT

GJETJET SIPAS BASHKIVE



Përmbledhjet më poshtë paraqesin situatën institucionale dhe operative në gjashtë bashkitë e analizuar. Fokusi është te kapacitetet e MZSH dhe Mbrojtjes Civile, burimet ujore, hidrante, akses i në terren, pajisjet, sistemet e paralajmërimit dhe përdorimi i të dhënave.



6

Bashki të angazhuara



3

Prefektura



20

Institucione të kontaktuara



12

Pyetësorë të plotësuar



59

Persona të kontaktuara



12

Vizita në terren

Divjakë



15 staf MZSH



2 mjete



6 hidrante



18 rezervuarë /
7 me probleme

Risku lidhet kryesisht me toka bujqësore, zona shkurre dhe periferitë të banuara. Bashkia ka dokumente të rëndësishme planifikimi përfshirë Planin Vendor të Emergjencave Civile 2024–2026, Strategjinë Vendore DRR 2024–2030 dhe vlerësimin vendor të riskut. Megjithatë, uji mbetet dobësia kryesore: rrjeti ka vetëm 6 hidrante dhe nevojiten rreth 20 të tjera për mbulim më të mirë operacional. Rezervuarët nuk janë gjithmonë të aksesueshëm ose të përshtatshëm për pompa. Mungojnë GIS, inventar digjital dhe sistem modern paralajmërimi.

Elbasan



35 staf MZSH



5 staf MC



6 mjete



2 hidrante /
50 të planifikuara

Elbasani ka strukturën më të konsoliduar në pellg, me MZSH dhe Mbrojtje Civile si drejtor i më vete. Koordinimi është më i zhvilluar se në bashkitë e tjera, por presioni operacional mbetet i lartë: raportohen 50–100 zjarre të vogla në vit pranë zonave urbane dhe 3–5 zjarre pyjore ose në ullishte. Kufizimet kryesore janë mungesa e pikave të ujit në zonat rurale, rrugët e vështira në terren kodrinor-malor, mungesa e mjeteve të vogla 4x4 dhe nevoja për GIS, digitalizim dhe hartëzim të hidrantëve.

Librazhd



16 staf MZSH



3 mjete / 2 shumë të vjetra



12 hidrante



11 zjarre pyjore në 2025

Librazhdi ka planifikim relativisht të mirë dhe koordinim funksional ndërmjet MZSH, Mbrojtjes Civile, sektorit të pyjeve dhe njësisve administrative. Megjithatë, territori malor dhe pyjor e bën reagimin të vështirë. Në vitin 2025 u raportuan 11 zjarre pyjore dhe mbi 15 zjarre urbane gjatë periudhës qershor-tetor. Hidrantet ka vetëm në qytet; zonat rurale dhe pyjore nuk kanë mbulim. Mjetet janë të amortizuara, Mbrojtja Civile nuk ka automjete të dedikuara dhe paralajmërimi varet kryesisht nga komuniteti.

Rrogozhinë



17 staf MZSH



1 mjet zjarrfikës



1 hidrant në stacion



150–200 ndërhyrje urbane/vit

Rrogozhina ka strukturë bazë funksionale, por kapacitetet janë të kufizuara. Zjarret lidhen kryesisht me toka bujqësore, pemëtore, ullishte dhe parcela të braktisura; raportohen 150–200 ndërhyrje vjetore në zona urbane dhe 3–5 zjarre të rëndësishme rurale/pyjore. Mungesa e hidrantëve në rrjet është kritike: ekziston vetëm një hidrant në stacion. Nuk ka autobus, pajisjet mbrojtëse janë minimale dhe rezervuarët janë të vështirë për t'u përdorur nga toka; bashkia shpesh varet nga stacionet fqinje ose operatorë privatë.

Kavajë



22 zjarrfikës



+2 staf mbështetës



3 mjete + 1 autobus



287 raste nga mbetje/bimësi

Kavaja ka stacion të rinovuar dhe strukturë institucionale më të fortë, por dobësi serioze në ujë, pajisje dhe logjistikë. Zjarret pyjore janë 3–5 në vit, ndërsa rastet nga djegia e mbetjeve dhe bimësisë pranë rrugëve janë shumë të shpeshta, me 287 incidente të raportuara. Jashtë stacionit, rrjeti i hidrantëve praktikisht nuk funksionon; zonat rurale dhe pyjore nuk kanë pika ujore të dedikuara. Pajisjet kryesore janë të vjetra, mungon autoskalla dhe Mbrojtja Civile varet nga drejtoritë e tjera për transport dhe logjistikë.

Përrenjas



14 staf MZSH



1 mjet i viti 1988



~16 hidrante / 20% mbulim



5–6 zjarre pyjore/vit

Përrenjas është ndër zonat më të vështira për shkak të terrenit malor, aksesit të dobët dhe mungesës së ujit në zona pyjore. Rrajca, Stravaj, Qukës dhe Pishkash raportohen si zona me mungesë burimesh ujore operative. Hidrantet mbulojnë vetëm rreth 20% të territorit dhe shumica e rezervuarëve janë të paarritshëm për automjete ose të papërshtatshëm për pompa. Mungojnë mjetet 4x4, autoboti, pajisjet për pompim nga burime natyrore, trajnime specifike dhe GIS.

MESAZHI KRYESOR



Bashkitë kanë vullnet dhe strukturë bazë, por kërkojnë investime të synuara në ujë për zjarre, akses në terren, mjete zjarrfikëse, sisteme digjitale, GIS dhe trajnim e praktik për të kaluar nga reagimi i rastit drejt një sistemi të qëndrueshëm parandalimi dhe përgjigjeje.

